

PROGRAMI QEVERISËS DHE SIFDAT SEKTORIALE

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim

Në vitin 2007, Shqipëria miratoi Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim për vitet 2007-2013, e cila është zhvilluar përmes një procesi me përfshirje të gjerë të gjithë palëve të interesuara në të gjithë vendin. SKZHI kërkon të (i) integroj vendin në EU dhe NATO; (ii) zhvillojë dhe konsolidojë shtetin demokratik, përmes reformave për të drejtat elektorale, gjyqësore dhe ato të pronës; dhe (iii) të arrijë zhvillim të shpejtë, të balancuar dhe të qëndrueshëm ekonomik, human dhe social. SKZHI ka vendosur një synim për rritje ekonomike në nivelin 6-7 përqind dhe synon ta ulë numrin e të varfërve nën 10% në vitin 2010. SKZHI shprehet se stabiliteti makroekonomik duhet të mbështetet nga konsolidimi fiskal dhe ulja e borxhit. Investimet në infrastrukturë do të përqendrohen tek rrugët dhe transporti, energjia, dhe furnizimi me ujë dhe higjena. Në aspektin e shërbimeve sociale, Qeveria kërkon të rrisë regjistrimet në arsimin sekondar në 76 përqind, të prezantojë një paketë bazë të përfitimeve të mbuluara në sektorin shëndetësor, të forcojë mbulimin e asistencës sociale, si dhe të reformojë sistemin e pensioneve publike. Për më tepër, pas zgjedhjeve Parlamentare të vitit 2009, Qeveria ripërsëriti theksin ndaj sektorit të ujit (duke përfshirë furnizimin me ujë dhe higjienën, por edhe vaditjen për të përmirësuar produktivitetin bujqësor) dhe sektorin e shëndetit si fusha ku do të përqendroheshin të ardhurat në 2-4 vitet e ardhshme.

Përmirësimi i Menaxhimit Makro, Procesimit të Buxhetit dhe Menaxhimit të Shpenzimeve Publike

Duke pasur parasysh ekspansionin e fundit fiskal, Shqipëria duhet të kthehet tek një politikë më e kujdesshme fiskale e cila i ka shërbyer shumë mirë ekonomisë gjatë viteve 2002-2007. Menaxhimi i shëndetshëm makro-ekonomik (veçanërisht një qëndrim i kujdesshëm fiskal, kurs fleksibël këmbimi dhe politika të shëndetshme monetare) ka qenë thelbësor për zgjerimin e shpejtë të ekonomisë gjatë shumicës së dekadës së shkuar. Gjithsesi, rritja e shpejtë e totalit të deficitit (dhe reduktimi i kursimeve publike) në 2009, qe rezultoi në nivelin e borxhit rreth 60% të PBB kanë ngritur shqetësime mbi kuadrin fiskal, veçanërisht në mungesën e një programi të ri të FMN që ka mundur mbështetje për politikën fiskale deri në përmbushjen e suksesshme të programit të fundit në vitin 2008. Duke parë pasigurinë në Evropë dhe në tregjet e kapitalit, Shqipëria duhet të lëvizë shpejtë për të tërhequr stimujt e fundit, të konsolidojë pozicionin e saj fiskal, rrisë kursimet publike dhe të fillojë të kthejë situatën e rritjeve të fundit në borxhin publik. Duhet theksuar se Shqipëria, me mbështetjen e Bankës, ka bërë hapa të rëndësishëm drejt forcimit të kapaciteteve institucionale për menaxhimin e borxhit, në kohë për aprovimin e saj nga IDA dhe hyrjen e saj në tregjet ndërkombëtar të kapitaleve (shih Kutia 1). Pavarësisht nga kjo, duke parë tendencat fiskale gjatë viteve të fundit, një kuadër i rishikuar fiskal do t'i shërbente mirë si një lloj mekanizmi mbështetës, si për shembull sundim fiskal, konsistent me qëndrueshmërinë e borxhit afatgjatë, për të rritur konfidencën e tregjeve fiskal dhe të investitorëve se Shqipëria është rikthyer tek eksperiencën e saj e fortë makro-ekonomike e së kaluarës. Pa mbështetjen e një politike fiskale të besueshme Shqipëria do të ishte në rrezikun e kostove më të larta të financimit dhe të pasigurisë për të siguruar financime, çka do të rriste paqëndrueshmërinë makro-ekonomike.

Shqipëria duhet gjithashtu të vazhdojë të forcojë sistemet e saj të menaxhimit të shpenzimeve, si forca shtytëse për politikën e saj fiskale dhe gjithashtu për implementimin efektiv të SKZHI. Shqipëria ka bërë një progres domethënës për të vendosur një kuadër institucional për buxhetin të shëndetshëm, së fundmi me miratimin e ligjit të ri për Buxhetin Organik i cili mishëron, ndër të tjera, praktikën afatmesme të buxhetit që janë ndjekur për disa vjet, dhe me procedurën e reja për planifikimin e investimeve publike. Gjithsesi, kjo duhet të shoqërohet nga: (i) përfundim më i fortë i rregullave dhe procedurave të reja; (ii) nga më shumë transparencë dhe më pak rialokime në fazën ekzekutive të buxhetit, për të ruajtur integritetin e proceseve vjetore dhe gjatë muajve të buxhetimit; dhe (iii) nga më shumë monitorim dhe analizë për të përfunduar incentivat për përmirësimin e kualitetit të planeve afatmesme të buxhetit. Plotësimi i sistemit të vonuar gjatë të Thesarit (që po ndodh aktualisht) dhe zhvillimi i mëtejshëm i sistemi informimi financiar të integruar do të lejonin jo vetëm forcimin e menaxhimit të përditshëm të shpenzimeve, por edhe të lidhnin shpenzimet me objektivat e SKZHI dhe rezultatet e programit, dhe të përmirësonin monitorimin e programeve të zhvillimit në tërësi. Në mënyrë të ngjashme, Shqipëria ka bërë gjithashtu disa hapa drejt përmirësimit të sistemit e saj të besimit. Ajo vazhdon të marrë mbështetjen e një numri partnerësh për zhvillim, jo më pak nga Banka dhe Bashkimi Evropian, për të plotësuar reformat e prokurimit publik dhe për të thelluar përmirësimet në menaxhimin financiar.

Kutia 1: Përmirësimi i Kapaciteteve të Menaxhimit të Borxheve në kohë për aprovimin nga IDA

Duke filluar nga 2007, me mbështetje nga Departamenti i Thesarit i Bankës Botërore dhe nga një fond i disa donatorëve për Sistemin e Integruar të Planifikimit (IPS), Shqipëria është përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme në aspektin e kapaciteteve teknike për menaxhimin efektiv të borxhit për t'ju përgjigjur aprovimit nga IDA dhe aksesit të reduktuar drejt huave koncensionare. Departamenti i Borxhit është ristrukturuar në linjë me praktikën më të mira ndërkombëtare dhe tashmë ka një staf të plotë ndarjen e përshtatshme të funksioneve. Një Sistem për Menaxhimin e Borxhit (DMS) për një periudhë tre vjeçare u prodhua në 2006 dhe u rishikua në vitin 2009. Nën këtë strategji, Qeveria arriti të zgjeronte maturitetin e borxhit të brendshëm nga 224 në 481 ditë, dhe në mënyrë graduale të ulte interesat e brendshëm të pagesave. Sistemi i Kontabilitetit Financiar për Menaxhimin e Borxhit (DMFAS) është në përdorim për borxhet e huaja dhe garancitë. Hapat e mëtejshëm përfshijnë prezantimin e një kuadri të qartë për menaxhimin e riskut për të vlerësuar balancën midis kostove dhe rreziqeve të pritura, dhe zgjerimin e DMFAS në borxhin e brendshëm.

Ndërtimi i konfidencës në menaxhimin makro-ekonomik të Shqipërisë do të kërkojë gjithashtu një përmirësim në prodhimin e statistikave kombëtare, në veçanti, për llogaritë kombëtare dhe fiskale. Shqipëria është përballur me një nevojë afatgjatë për të forcuar statistikat e saj makroekonomike dhe ka marrë një seri mbështetjesh nga donatorët për këtë qëllim por asistencën ka qenë shumë e vogël dhe relativisht e pakoordinuar. Statistikat për llogaritë Kombëtare, ato të punës dhe të punësimit janë fushat më të dobëta, dhe kërkojnë vëmendje urgjente duke pasur parasysh rëndësinë e tyre si sinjale kyç për aktorët ekonomik në një ekonomi moderne tregu. Në mënyrë më urgjente, gjithsesi, ka gjithashtu një nevojë kritike për respektimin e një procesi kalendarik për shpërndarjen e të gjithë të dhënave makroekonomike. Kriza globale financiare u ndoq nga një tendencë në shumë vende drejt një menaxhimi më të fokusuar të prodhimit dhe shpërndarjes së statistikave kombëtare kyç. Kriza aktuale në Greqi tregon rrezikun e mospasjes së të dhënave ekonomike të sakta, transparente dhe koherente. Përfundimi i kapacitetit dhe pavarësisë së Institutit Kombëtar të Statistikave për të prodhuar statistika të qëndrueshme dhe të

pavarura do të ndihmonte gjithashtu për mbështetjen e mëtejshme të mirëqenies dhe besueshmërisë së politikave makroekonomike në Shqipëri.

Forcimi i Kuadrit për Investimet Private

Në vitet e fundit, Shqipëria ka marrë hapa të rëndësishëm drejt përmirësimit të kuadrit rregullator për biznesin. Qeveria ka implementuar një reformë gjithëpërfshirëse për vendosjen e një sistemi rregullator efikas, të qëndrueshëm dhe transparent, me qëllimin e rritjes së niveleve të investimit, shtimit të konkurrencës dhe për të stimuluar rritjen e biznesit. Këto përpjekje janë reflektuar në indikatorët dhe renditjen e përmirësuar në Doing Business: Shqipëria u rendit e 82 në vitin 2010 nga e 136 në 2007. Performanca e saj në indeksin e Konkurrueshmërisë Globale dhe në Indeksin për Lirinë Ekonomike të Fondacionit Heritage është përmirësuar gjithashtu në mënyrë domethënëse gjatë viteve të fundit. Gjithsesi, renditjet në tërësi tregojnë një variacion të konsiderueshëm të renditjeve për indikatorë të veçantë. Për shembull, renditja e vendit në *Doing Business* luhatej nga e 15^a për mbrojtjen e të drejtave të aksioneve në minoritet, tek 91a për përforcimin e kontratave, tek 173^a për marrjen e lejeve të ndërtimit, Indeksi për Lirinë Ekonomike përfshin disa pikë relativisht të ulëta për mbrojtjen e të drejtave të pronës dhe lirisë nga korrupsioni. Për më tepër, mjedisi i biznesit mbetet më i vështirë për gratë të cilat përfaqësohen pak në pronësi të firmave, krahasuar me vendet e tjera të EAQ.

Një mangësi domethënëse mbetet midis adaptimit zyrtar të politikave rregullatore dhe implementimit të tyre dhe përforcimit, e shpjegueshme deri diku nga sundimi ende i dobët i ligjit. Mangësia e përforcimit në mënyrë domethënëse kufizon të ardhurat për investimet private në Shqipëri, duke përfshirë investitorët e huaj dhe ata lokal dhe duke vendosur kosto kohore dhe ‘taksa’ ryshfeti, duke mënjanuar kështu disa përfitime nga reforma rregullatore. Analiza e studimeve më të fundit për firmat (2007-08) tregon që produktiviteti i firmave, prirja për të eksportuar dhe krijimi i punësimit prej tyre pengohet nga mungesa e parashikueshmërisë për përforcimin e rregullave, dhe nga koha që duhet për t’u përshtatur me rregullat. Ndërkohë, Shqipëria vazhdon të përballlet me renditjet më të ulëta të saj në Indikatorët Global të Qeverisjes¹ (WGI) për sa i përket *kontrollit të korrupsionit dhe sundimit të ligjit*, të cilat janë të vetmet fusha për të cilat ka një mesatare respektivisht të njëjtë dhe më të ulët se ajo e vendeve me të ardhura të mesme të vogla.

Klima e investimeve në Shqipëri është gjithashtu e rrezikuar nga të drejtat e paqarta mbi pronësinë dhe dobësitë në administrimin e tokës. Një studim i kryer në 2008 si pjesë e Vlerësimit për Klimën e Investimeve (ICA) zbuloi se të drejtat e pasigurta të pronësisë dhe aksesit ndaj tokës ishin konsideruar si pengesa serioze për investimet nga një grup i madh firmash, ku firmat e vogla dhe të mesme ndikoheshin në mënyrë disproporcionale. Për më tepër, evidenca sipas rasteve tregonte se investitorët e huaj shpesh i mënjanohen investimit në Shqipëri për shkak të vështirësive në arritjen e aksesit të tokës apo lejeve me tituj të qartë ligjor. Përkeqësimi i pasigurisë që rrethon të drejtat e pronësisë është dhe pamundësia e dukshme e gjykatave për të zgjidhur në mënyrë të suksesshme zënkat dhe/apo për të përforcuar vendimet e marra përmes proceseve gjyqësore. Qeveria është e ndërgjegjshme për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e pronësisë dhe implikimet që ato sjellin për investimet private ndaj ka adaptuar

¹ Indikatorët WGI gjithashtu përfshijnë zërin dhe përgjegjshmërinë, stabilitetin politik, efektivitetin e qeverisë dhe kualitetin rregullator për të cilat Shqipëria është përmirësuar së tepërmi në krahasim me dekadën e fundit.

disa përgjigje të përshtatshme politike. Gjithsesi, zbatimi i tyre ka çaluar si pasojë e një kuadri ligjor shumë variabël, dështimeve në koordinim, kufizimeve në kapacitet dhe korrupsionit.

Për më tepër, Shqipëria përballlet me një sfidë domethënëse për sa i përket mbështetjes së bizneseve private gjatë adaptimit të teknologjive më të sofistikuar që nevojiten për të arritur standardet dhe rregullat e BE. Ndërkohë që autoritetet arrijnë progres duke prezantuar rregullat dhe standardet e reja të BE, ka një nevojë jo vetëm për të përmirësuar implementimin e tyre nga ana e sektorit publik, por edhe për të krijuar një ambient i cili lejon firmat private që të marrin njohuritë e nevojshme teknike për t'ju përshtatur me këto kërkesa. Eksportuesit Shqiptar janë të renditur në fund të tregut global, duke u përfshirë vetëm në procese pa-aftësi të veçanta dhe me pakë vlerë të shtuar ndaj produktit. Një numër i kufizuar programesh po përgatiten, të financuar si nga qeveria ashtu dhe nga partnerët për zhvillim për të rritur kapacitetin në të dy krahët për të implementuar rregulla të reja, në veçanti në sektorin bujqësor. Gjithsesi, këto duhet të shoqërohen nga vëmendja drejt pengesave në sistem që ndalojnë ndryshimet e zakonshme për adaptimin e njohurive dhe të inovacionit, për shembull, lidhjet me investimet e huaja të drejtpërdrejta, promovimin e trajnimit brenda firmës të punëtorëve dhe një infrastrukturë efektive me kualitet dhe standarde.

Zvogëlimi i Mangësive në Infrastrukturë

Rritja e infrastrukturës me kualitet të mirë është një tjetër element kritik i përpjekjeve të Qeverisë për të përmirësuar klimën e investimeve private dhe rritjes, dhe për të siguruar një përfshirje më të gjerë. Firmat e intervistuarat për vlerësimin e konkurrueshmërisë nga Banka për ICA identifikuan pengesa në infrastrukturë – furnizimi me energji elektrike, telekomunikimi dhe transporti (duke përfshirë logjistikën) – si mangësitë më të mëdha për rritjen dhe investimet.

Paqëndrueshmëria dhe kualiteti i dobët i furnizimeve me elektricitet është cituar në mënyrë të rregullt nga firmat Shqiptare paçka madhësisë së aktivitetit, si një nga pengesat e tyre më kritike. Në vitin 2008, firmat raportuan një mesatare prej 32 shkurtimesh të energjisë në muaj, çka i detyronte të mbështeteshin tek gjeneratorët dhe të harxhonin për pajisjet e sofistikuar teknologjike që mund të dëmtoheshin nga luhatjet e energjisë. Të qartë për seriozitetin e kësaj situatë, Qeveria, në bashkëpunim të afërt me Grupin e Bankës, ka ndërmarrë një reformë madhore të sektorit të energjisë duke filluar nga viti 2008, por mbetet akoma shumë për të bërë. Qeveria ka filluar ristrukturimin e sektorit të energjisë: kompania shtetërore e energjisë elektrike, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), u 'çmontua' dhe bizneset e shpërndarjes dhe të furnizimit u privatizuan. Nën kuadrin e ri të tarifës së elektricitetit, OSSH-ja e privatizuar duhet të arrijë objektivat e performancës për: (i) të ulur humbjet në transmision dhe shpërndarje; (ii) të rritur nivelet e mbledhjes së të ardhurave; (iii) përmirësimin e efektivitetit operacional; dhe (iv) përmirësimin e kualitetit të elektricitetit. Sektori ka filluar që tani që të ketë disa përmirësime të dukshme, pjesërisht prej reformës në menaxhim por edhe për shkak të kushteve më të mira hidrojogjike, forcimin e entiteteve rregullator, dhe privatizimin e furnizimit. Tre vitet e ardhshme do të jenë veçanërisht kritik për bërjen efektive të strukturës dhe modelit të ri të tregut. Së pari, realizueshmëria financiare, menaxheriale dhe teknike e kompanive me pronësi publike të energjisë në zinxhirin e furnizimit duhen të forcohen dhe vijimisht prapambetjet brenda kompanive të kufizohen. Së dyti, ekziston një nevojë për ta bërë efektiv privatizimin e sektorit të shpërndarjes përmes, ndër të tjera, investimeve të reja për të reduktuar humbjet e energjisë gjatë shpërndarjes. Së treti, Qeverisë do t'i duhet të rrisë më tej kapacitetin

gjenerues, veçanërisht përmes projekteve të vogla por efikase hidro-energjetike. Së fundmi, detyrimet kontingjente të sektorit ndaj qeverisë duhet të kufizohen në mënyrë substanciale.

Infrastruktura e papërshtatshme e telekomunikacionit në Shqipëri gjithashtu shihet si një pengese për të kryer biznesish, por Qeveria ka kaluar një kuadër ligjor për telekomunikacionin në 2007 që po ndihmon krijimin e një tregu konkurrues. Ne te shkuaren, një numer i konisedueshem kompanish ka raportuar se shërbimet e papërshtatshme dhe të kushtueshme të telekomunikacionit janë një pengesë për të kryer biznes (BEEPS 2005 dhe 2008). Ne pergjigje te ketyre ceshtjeve, qeeria kaloi nje ligj te ri ne 2007, i cili ka cuar ne permiresime te dukshme perfshire futjen e nje operatori telefonie te trete celulare ne treg. Si rezultat ka pasur nje rritje te dukshme te numrit te perdoruesve te sherbimeve te telekomunikacionit dhe ulje te ndjeshme te koston dhe cilesi sherbimi me te mire. Permiresime te tjera do te kerkojne zbatimin e vazhdueshem dhe efektiv te ligjit te ri duke perfshire te paktën katër elemente në periudhën afatshkurtër deri afatmesme: (i) rregulla të përshtatshme për sa i përket interkonjeksionit; (ii) mbartshmëri të numrave; (iii) shtytjen e konkurrencës brenda tregut; dhe (iv) alokimin kompetitiv të frekuencave 3G dhe WiMax.

Shqipëria është përmirësuar në mënyrë të qëndrueshme në infrastrukturën e saj të transportit, por ka akoma shumë rrugë për të bërë përpara se rrjeti i rrugëve të arrijë standardet mesatare për vendet me të ardhura të mesme të vogla dhe ka nevojë për më shumë fokus drejt mirëmbajtjes. Gjatësia totale e rrjetit të rrugëve për Shqipërinë është rreth 14,500 km. Fokusi i aktual ka qenë drejt zhvillimit të rrjetit dhe ka pasur disa investime në seksione të shkurtra dhe të pandërprera të autostradave (duke përfshirë Tiranë – Durrës, Rrëshen – Kalimash) – por standardi i rrjetit primar mbetet i papërshtatshëm. Ndërkohë, rrjeti i rrugëve lokale (rreth 4,411 km) është gjithashtu në kushte shumë të këqija ku vetëm 39% e rrugëve janë shtruar. Vendosi e kohëve të fundit e programit të gjerë për Rrugët Sekondare dhe Tretësore, i cili synon të rikonstruktojë dhe rehabilitoj 1700 km rrugësh lokale, duhet të sjellë një përmirësim domethënës. Në këtë fazë, prioritetet kyç për sektorin e rrugëve janë: (i) zhvillimi i lidhjes në rrjetin e rrugëve dhe sjellja e tij në standarde uniform që janë të krahasueshme me vendet e tjera të rajonit; (ii) tejkalimin e prapambetjeve në mirëmbajtje; (iii) mundësimin e sistemeve të qëndrueshëm menaxherial dhe financiar; dhe (iv) të vazhdojë reformën institucionale dhe forcimin e kapaciteteve për të përmirësuar institucionet e sektorit, si për shembull, të sapo krijuarin, Autoritet Shqiptar të Rrugëve. Në mënyrë paralele, vendi duhet gjithashtu të përmirësojë infrastrukturën dhe shpërndarjen e shërbimeve, në nën-sektorët e portit dhe të hekurudhës, përmes përfshirjes së sektorit privat, programeve të renditjes në Be dhe iniciativave rajonale.

Infrastruktura e Vadijes është jetësore për të forcuar avantazhin konkurrues të sektorit të Bujqësisë por mbetet në kushte të dobta dhe duhet të adaptohet me kushtet e ndryshimit klimaterik. Ndërkohë që Shqipëria ka reshje të shumta vjetore, më pak se 20 përqind ndodh gjatë periudhës nga Prilli në Shtator çka e bën vadijen të nevojshme për të mbjellat e verës dhe ato gjithëvjetore. Drenazhi dhe mbrojtja nga përmytjet është gjithashtu e rëndësishme për bujqësinë, veçanërisht në ultësiat bregdetare. Edhe pas një dekade investimesh për të rehabilituar sistemin e gjerë të vadijes dhe drenazhit (një trashëgimi e komunizmit), vetëm një e treta e sistemit vazhdon të mbetet për t'u rehabilituar, dhe digat në rrjedhat e sipërme si dhe burimet ujore kërkojnë vëmendje. Ndërkohë që strukturat institucionale për funksionimin dhe mirëmbajtjen mbeten të dobëta– Shqipëria është ende duke kërkuar për mekanizma të qëndrueshëm dhe efektiv për të menaxhuar sistemet e vadijes dhe drenazhit të cilat mund të

përballen më mirë me nevojat e ndryshme të sektorit Shqiptar të Bujqësisë. Qeveria ka bërë përmirësime të mëtejshme të sistemit të vaditjes, duke përfshirë përdorimin e metodave më moderne si vaditja me pikim, një prioritet madhor në mënyrë që të rriten produktiviteti i sektorit bujqësor.

Zgjerimi dhe Mbështetja e Përfitimeve Sociale

Shqipëria ka qenë krahasimisht më pak e suksesshme në zgjerimin e përfitimeve nga ekonomia e saj e tregut në zgjerim për popullatën e gjerë. Rritja, deri më tani, ka qenë kryesisht pa vende pune me rritje marginale në punësim. Ndikimi i rritjes në zvogëlimin e varfërisë është arritur kryesisht përmes rialokimeve sektoriale të punësimit, remitanacave nga emigrantët për familjet e tyre, si dhe rritjet në rrogat e sektorit publik dhe në pensione. Për më tepër, indikatorët social në shëndetësi dhe arsim, dhe në mbulimin dhe përshtatshmërinë e sistemeve të mbrojtjes sociale, mbeten në mënyrë domethënëse pas mesatares së BE10 dhe fqinjëve rajonal të Shqipërisë. Rikuperimi i ngadaltë ekonomik ka gjasa të prekë ata më vulnerabël çka do kërkojë një vëmendje më të madhe për të përmirësuar efektivitetin e sistemeve të mbrojtjes sociale. Gjithsesi, However, the skenari i atyre vulnerabël ka shumë gjasa të jetë i orientuar nga ana gjinore, duke qenë se gratë përballen me më shumë sfida në tregun e punës në krahasim me burrat.

Në Arsim, sfida kryesore me të cilën përballen qeveria e Shqipërisë është përmirësimi i kualitetit në të gjithë nivelet ndërkohë që gjithashtu përmirësohet aksesin, veçanërisht për arsimin sekondar dhe atë të mesëm si dhe për shtëpitë rurale dhe minoritetet. Kjo do të kërkojë rritjen e regjistrimeve të ulta në arsimin sekondar të djemve dhe vajzave (Shqipëria nuk ka diferencë domethënëse gjinore përsa i përket regjistrimeve sekondare, shih **Error! Reference source not found.** në faqen **Error! Bookmark not defined.**), zvogëlimin e mos-barazive urbane-rurale, dhe të sigurojë që studentët janë më shumë të përgatitur për t'u përgjigjur kërkesave të tregut të punës. Shqiptarët kanë, mesatarisht, më pak vite shkollim në krahasim me mesataret e BE dhe ato nën-rajonale, dhe më pak studentë vazhdojnë arsimin e lartë. Ka gjithashtu grupe vulnerabël ku veçanërisht shihen shumë pakë regjistrime, edhe në edukimin bazik. Kualiteti, siç matet nga testet e standardizuar, gjithashtu paraqet sfida serioze. Për të adresuar këto sfida, Qeveria ka zhvilluar një Strategji Kombëtare për Arsimin (SKA) për vitet 2004-2015 (që mbulojnë arsimin para-universitar) e cila e vendos theksin te përmirësimet e kualitetit si një mënyrë për të inkurajuar regjistrimet në arsimin e lartë. Autoritetet kanë nisur gjithashtu një strategji të veçantë për arsimin e lartë e cila fokusohet në përmirësimin e qeverisjes dhe, mekanizmat e financimit në universitetet publik.

Deri më sot, Qeveria ka bërë një progres të mirë drejt implementimit të strategjisë Kombëtare të Arsimin, por do t'i duhet të ndjekë reforma të përshtatshme në mënyrë që të arrijë rezultate arsimor të krahasueshëm me EU10 dhe Kroacinë. Në fundin e vitit 2009, një e katërta e të gjithë mësuesve kishin marrë një arsim të vazhduar, raporti student-kompjuter ishte ulur në 25 nga 61; dhe mbipopullimi i shkollave po adresohet duke pasur vetëm 18 përqind të studentëve që ndjekin disa turne në krahasim me 36 përqind të tre viteve më parë. Në terma të promovimit të përgjegjshmërisë në nivel shkollor, të gjithë drejtuesit e shkollave janë trajnuar për menaxhim dhe leadership në arsim dhe 90 përqind e shkollave të nivelit para universitar raportojnë se kanë një bord funksional por *de facto* përgjegjësia për proceset/procedurat mbetet për t'u transferuar. Në nivelin e arsimin të lartë, reformat janë gjithashtu janë ndërmarrë, edhe pse me një rritëm më

të ngadaltë. Ligji për arsimin e lartë u rishikua dhe po implementohen aktualisht. Të gjithë universitetet kanë vendosur një bord të jashtëm qeverisës dhe rreth 70 përqind e universiteteve kanë zhvilluar plane strategjik. Qeveria po kryen aktualisht diskutime mbi reformën në kurrikula dhe po zhvillon një plan veprimi për të implementuar procesin e Bolonjës. Për më tepër, po konsiderohet zhvillimi i skemës së incentivave për të tërhequr studentët dhe për të mundësuar resurse në zona ku aftësitë mungojnë.

Shqipëria vazhdon të mbetet mbrapa vendeve të tjera të rajonit si dhe vendeve të tjera me të ardhura të mesme të vogla në të gjithë botën për sa i përket rezultateve në shëndetësi. Kujdesi Shëndetësor gjithashtu mbetet një fushë kritike në të cilën familjet ndikohen nga korrupsioni, ku thuhet një e treta e të pyeturve të sondazheve shprehen se u është dashur të paguajnë ryshfet për të marrë përkujdesje shëndetësore. Shpenzimet publike në shëndetësi vazhdojnë të jenë të ulëta (2.7 përqind e PBB), por totali i shpenzimeve për kujdesin shëndetësor nga sektori privat dhe publik është i krahasueshëm me vendet e tjera me të ardhura të mesme të vogla, rreth 6.5 përqind e PBB. Pagesat direkte përbëjnë rreth 60 përqind të totalit të financimeve, dhe niveli i lartë i pagesave informale shkakton pabarazi për sa i përket aksesit ndaj kujdesit shëndetësor, ku të varfërve u duhet shpesh të heqin dorë nga kujdesi i domosdoshëm.

Reformat e filluara për të përmirësuar shërbimet e shpërndarjes dhe financimit të kujdesit të shëndetit nuk janë implementuar plotësisht dhe ende mbeten probleme serioze për sa i përket: (i) pabarazive rajonale dhe aksesit të pabarabartë; (ii) sistemeve të pagesës që janë të pa përshtatshme për të promovuar kontrollin e kostos apo përdorimin efikas të resursit; dhe (iii) aftësitë e dobëta menaxheriale të sektorit. Qeveria ka qenë e përkushtuar që të ndërmarrë reforma në disa fusha. Së fundmi, u prezantua një program i gjerë për të rehabilituar objektet e kujdesit primar. Aktualisht po implementohen një sistem për edukim të vazhdueshëm mjekësor dhe rilicensimi i stafit mjekësor; dhe Ministria e Shëndetit ka zhvilluar udhëzime të praktikës klinike për sëmundjet më të zakonshme, të cilat po u shpërndahen ofruesve të Kujdesit Primar Shëndetësor (KPSH). Për më tepër, Qeveria ka ndërmarrë hapa fillestar drejt përmirësimit të mekanizmave shpërndarjes së resurseve përmes zhvillimit të planit kombëtar për racionalizimin e shërbimeve spitalore. Arritja e një rezultati të plotë të këtyre reformave ka gjasa të hajë disa vjet dhe do të përfshijë ndryshime në sjelljen dhe incentivat si nga ana e pacientëve ashtu dhe në atë të ofruesve.

Zhvillimi i shpejtë i Shqipërisë është shoqëruar me ulje drastike të nivelit të varfërisë, por ka pengesa të mundshme në këtë aspekt të cilat duhen adresuar dhe grupe në nevojë (veçanërisht familjet e papuna) të cilave u nevojitet mbështetja e Qeverisë. Vendi ka reformuar ngadalë masat siguruuese në programe moderne, të mirë drejtuara dhe efektive të mbështetjes sociale. Arritja e progresit në këtë aspekt po bëhet gjithmonë e më shumë e rëndësishme në terma të menaxhimit fiskal, për shkak të peshës së madhe të këtyre shpenzimeve në buxhet dhe tendencave të fundit ekspansionare, për shembull, fryrja e shpenzimeve të fondit për të paaftët. Sistemi i pensioneve ka gjithashtu deficite fiskale domethënëse afatgjata dhe shpërndarje të ngushtë.

Ka mundësi domethënëse për të përmirësuar orientimin dhe administrimin e programit kryesor Shqiptar të përfitimeve sociale, Ndihma Ekonomike (NE). Përfituesit më të varfër marrin vetëm 56 përqind të transfertave të NE, dhe përfitimet përbëjnë vetëm 14 përqind të konsumit të para-transfertave të përfituesve. Ka mundësi domethënëse për të përmirësuar

mekanizmat orientues, për të reduktuar lirinë e veprimit si dhe mundësi për abuzime. Proceset Administrative gjithashtu mbeten tepër të rënda me kosto të fryra transaksioni për aplikantët nga kërkesat e shumta për dokumente për të cilat administratorët u duhet të koordinohen me disa agjenci në nivele të ndryshme të administratës publike. Prezantimi i regjistrimit kombëtar dhe data bazave elektronike do të rriste në mënyrë domethënëse efikasitetin e orientimit dhe administrimit, si dhe do të ndihmonte në uljen e kostove të sistemit. Qeveria e ka vendosur përmirësimin e administrimit të përfitimeve sociale si një nga prioritetet e saj më të larta dhe ka përgatitur një projektligj që prezanton reformat në orientim dhe administrim për NE.

Shpenzimet për përfitimet mos-kontribuuese për të paaftët është jo-proporcionale me numrin e përlllogaritur të personave me paaftësi. Përfitimet për të paaftët përbëjnë më shumë se gjysmën e totalit të shpenzimeve për asistencën sociale. Gjatë viteve 2000-2008, si numri i përfituesve të paaftë ashtu dhe niveli mesatar i përfitimeve për paaftësi u rritën thellësisht. Një diagnostifikim fillestar i programit të të paaftëve tregon se legjislacioni për të paaftët është i shpërndarë, kriteret kualifikimit mjekësor janë të prapambetur, dhe sistemi aktual i vlerësimit të rasteve të paaftësisë është i hapur ndaj konflikteve të interesit. Së fundmi duhet theksuar se shkëputja e nivelit operacional midis institucioneve që menaxhojnë pjesë të ndryshme të mbrojtjes sociale shkakton mundësi të humbura për përmirësimin e efektivitetit që lind nga lidhja e këtyre shërbimeve.

Së fundmi, Sistemi i pensioneve në Shqipëri nuk është i qëndrueshëm në aspekti afatgjatë. Një strukturë e përmbledhur përfitimesh, edhe pse rishpërndarëse, jep pak shtysa që individët të kontribuojnë dhe/apo deklarojnë të ardhurat ekzakte. Si pasojë, një pjesë e vogël e popullsisë në moshë pune kontribuon për sistemin e pensioneve në Shqipëri por ky sistem duhet të financojë disa gjenerata të moshuara, shumica e të cilëve kanë të drejta të plota pensioni. Për më tepër, rolet e pensioneve dhe programeve të asistencës sociale nuk janë përcaktuar qartësisht. Në zonat rurale, degët e pensioneve dhe asistencës sociale të sistemit janë zhvilluar në mënyrë të atillë që pensionet rurale janë kthyer praktikisht në përfitime të asistencës sociale. Pensionistët rural paguajnë kontribute bazuar në një shumë të sheshtë, por shumica e kontributeve të tyre paguhet nga Qeveria. Zbatimi sporadik i indeksimit të pensioneve sjell pasiguri. Administrata e pensioneve është e dobët, ku disa prej të dhënave të shkuara janë akoma të regjistruara në letër. Qeveria Shqiptare e ka vendosur reformën e administrimit të sistemit të pensioneve si një nga prioritetet kryesore, por ka vonuar përpjekjet për masat e nevojshme për të pasur një konsensus me bazë të gjerë dhe multipartiak. Ndërkohë, po kryhen disa përpjekje për të përmirësuar administrimin, duke përfshirë dhe prezantimin e një sistemi të ri arshive dhe informacioni.

Forcimi i Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe Përshtatja me Ndryshimet Klimaterike

Shqipëria është e pasur në resurse ujore por infrastruktura e saj ambientale është prapa asaj të vendeve të tjera të rajonit dhe institutet hidrologjike janë të dobët. Njohuria e pamjaftueshme për rolin qendror që kanë burimet ujore dhe ndërlihdjet që përdorimet e ndryshme të ujit kanë në ekonomi kanë kontribuar në një situatë të vazhdueshme nën-financimi dhe dobësimi të institucioneve që menaxhojnë resurset ujore. Shqipëria gjithashtu ndan disa prej lumenjve dhe liqeneve të saj me vendet fqinje, çka e bën të domosdoshme vendosjen e institucioneve efektive rajonale për të siguruar menaxhim të përshtatshëm të këtyre resurseve.

Erozioni i tokës në rrjedhat e sipërme dhe sedimentarizimi i rrjedhave të poshtme përbëjnë që tani një shqetësim në rritje, për shkak të ndikimit të shoqëruar në kualitetin e ujërave bregdetar dhe në potencialin e Shqipërisë për turizëm. Ky erozion dhe sedimentarizim është evident në fushat e shumta të braktisura (të pa kultivuara) dhe të lërueshme por edhe në shtretërit dhe deltat e lumenjve. Kjo është shkaktuar nga prerjet e paligjshme të pemëve, përdorja e tepruar për kullota, dhe nga nxjerrja e resurseve të zhavorrit pa asnjë rregull. Miliona ton inerte depozitohen në lumenj dhe shtyhen për në detin Adriatik çdo vit. Pyjet dhe ujëmbledhëset në zonat malore përballen me trysni në rritje si pasojë e erozionit, prerjeve ilegale, dhe zhvillimit, por kapaciteti lokal për të menaxhuar resurset është i kufizuar. Mungesa e infrastrukturës së nevojshme ambientale dhe shërbimeve në bregdetin jugor të Shqipërisë gjithashtu përkeqëson rrezikun e dëmtimit të burimeve natyrore në kurriz të zhvillimit të prititur turistik..

Ndikimi i ndryshimeve klimaterike në Shqipëri pritet të jetë i ashpër, me ndryshim të motit dhe të rrjedhave ujore në pjesë të ndryshme të vendit. Shqipëria është vendi i dytë më vulnerabël ndaj ndryshimeve klimaterike në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore, për shkak të rritjeve të mundshme në variablen e reshjeve dhe topografisë së rrëpirë të Shqipërisë dhe për shkak të vartësisë së saj nga uji për energji dhe bujqësi. Parashikimet e ndryshimeve të klimës sugjerojnë se Shqipëria po bëhet një vend më i ngrohtë dhe më i thatë, me thatësira më të shpeshta dhe reshje ekstreme. Varieteti dhe intensiteti në rritje i reshjeve pritet të rrisë pasiguri dhe risqe ekonomike për fermerët, menaxherët e ujit, prodhuesit e energjisë, prodhuesit e manifakturës, menaxherët e transportit dhe operatorët turistik. Këto varietete hidrologjike gjithashtu rrisin rrezikun e katastrofave natyrore nga përmbytjet, erozioni dhe rrëshqitja e dherave.

Ndryshimet e kohëve të fundit në aktivitetin e motit, të cilat po shkaktojnë incidente të shumta të përmbytjes në të gjithë vendin dhe përmbytje katastrofike në veriun e Shqipërisë në Janar të 2010, kanë rritur fokusin e autoriteteve në ndikimet më imediate të ndryshimeve klimaterike. Infrastruktura Shqiptare e mbrojtjes nga përmbytjet është ndërtuar për skenar më pak ekstrem klimaterik krahasuar me ato që janë përjetuar kohët e fundit, ndërkohë vendosja institucionale për menaxhimin e koordinuar të rrjedhave sipërfaqësore të ujërave nuk funksionon në mënyrë efikase. Duke parë natyrën e investimeve në bujqësore dhe urbane në zonat e ulëta, risku ekonomik i përgatitjes së dobët është shumë i lartë. Në përgjithësi, përgatitja e Shqipërisë dhe kapacitetet e reagimit për katastrofat natyrore, ku përfshihen edhe tërmetet, janë të limituara dhe burimet fiskale janë të pakta. Shërbimet e saj hidro-meteorologjike mbeten pas në krahasim me rajonin dhe nuk ka një sistem ekzistues për paralajmërim të hershëm.

Vartësia e lartë e Shqipërisë në resurset e saj ujore—për prodhimin e hidro-energjisë dhe vaditje për sektorin e rëndësishëm të bujqësisë, si dhe për përdorim shtëpiak – e bën të domosdoshëm adresimin e sfidës që i përket ndryshimeve klimaterike në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të integrua. Hidrocentralet Shqiptare prodhojnë 90% të energjisë së vendit, por mungesat institucionale, në monitorim, dhe në infrastrukturë lënë vend për përmirësime në efikasitetin e përdorimit të ujit dhe menaxhimin e tij. Përpjekjet e vazhdueshme të Qeverisë për të zhvilluar potencialin e paprekur hidroenergjetik për impiante të mëdha dhe të vogla duhet të konsiderohet me kujdes në mënyrë që të ruaj të drejtat e përdorimit të ujit dhe për qëllime të tjera. Sektori i vaditjes, deri më tani përdoruesi më i madh i ujit, përbën rreth 70 përqind të gjithë përdorimit, ka vuajtur gjithashtu nga financimet e pamjaftueshme dhe kuadri i papërshtatshëm menaxhues që kanë shkaktuar përkeqësimin e infrastrukturës dhe furnizim të paqëndrueshëm me ujë. Shumë rezervuar bujqësor nuk mund të përdoren në kapacitetin e tyre të

plotë të mbajtjes së ujit, duke e reduktuar kështu funksionimin e tyre si mbrojtës ndaj përmytjeve. Erozioni në zonat e larta dhe sedimentarizimi kanë reduktuar së tepërmi kapacitetin ruajtës, dhe fermerët gjithnjë e më shumë po instalojnë puse pa konsideruar kërkesat e tjera për ujërat nëntokësor. Aksesit i zgjeruar për furnizimet ujore të bashkive konkurron me të njëjtin ujë sipërfaqësor dhe nëntokësor si vaditja dhe hidroenergjetika, dhe me problemin e shtuar të rekrutimit të masave të forta mjedisore për të ruajtur kualitetin e ujit.

Furnizimi urban me ujë i Shqipërisë gjithashtu mbetet tejet inefikas, me 73përqind të ujit të pa llogaritur ndërkohë që qyteti mesatar furnizon vetëm 12 orë ujë të pijshëm në ditë. Për më tepër, përshtatja me standardet e vendosura mikrobiologjike është në mënyrë të vazhdueshme e ulët. Vendi ka vetëm një impiant funksional të trajtimit të ujërave të zinj– disa të tjerë po ndërtohen – dhe mbrojtja mjedisore e burimeve ujore dhe ujërave bregdetare është sporadike. Ujërat sipërfaqësor dhe nëntokësor që përbëjnë burimin kryesor të ujit të pijshëm rrezikojnë ndotjen si rezultat i derdhjes së ujërave të pa-trajtuar të kanalizimeve në lumenj dhe det, dhe nga hedhja e papërshtatshme e mbeturinave solide në brigjet e lumenjve. Qeveria ka decentralizuar së fundmi menaxhimin e 52 organeve bashkiak të furnizimit me ujë tek qeveritë lokale, por vazhdon të mundësojë nivele relevante subvencionesh për sektorin. Janë ndërmarrë një numër eksperimentesh me pjesëmarrjen private të cilat nuk kanë rezultuar shumë të suksesshme për shkak të madhësisë së vogël të objekteve. Pasi u ka treguar donatorëve të huaj që ky sektor nevojitet të ketë një fokus kryesor për mbështetje të vazhdueshme infrastrukturore, Qeveria po përgatit një program të gjerë e të koordinuar reforme, investimesh dhe ndërtimi kapacitetesh për këtë sektor, ku një prioritet është progresi i shpejtë drejt standardeve të BE.

Sfida e Shqipërisë do të jetë që të lëvizë shpejt për të kuptuar dhe adaptuar infrastrukturën dhe përdorimin e saj në mënyrë që të mirë-menaxhohet, të mirëmbahet dhe të bëhet më efikase përdorimi i resurseve ujore të vendit. Rezerva e gjerë e infrastrukturës ujore në Shqipëri përbën një themel të shkëlqyer për të adresuar menaxhimin e resurseve ujore. Disa prej punimeve janë në rrugë e sipër për të zhvilluar modele më të mira hidrologjike për lumenjtë kryesor dhe liqenet ndër-kufitare, përmirësimin e sigurisë së digave, rezervuarëve dhe menaxhimit të hidrocentraleve, për teknika të reja dhe të përmirësuara vaditje, dhe për përcaktimin e programeve të mëdha të investimit për të përmirësuar furnizimin e bashkive me ujë dhe higjienën. Gjithsesi, në mënyrë që të përfitojë nga mundësitë e saj për t’u adaptuar, nevojitet një përpjekje e disa sektorëve me mbështetjen e vazhdueshme të përdoruesve ndër qeveritar (qendror dhe lokal) dhe atyre përfundimtar.